



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 02 korrik 2012
Nr. ref: AGJ264/12

AKTGJYKIM

në

Rastin Nr. KI51/11

Parashtruesi

Rexhep Rahimaj

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan,
Ac. nr. 359/10, të 14 dhjetorit 2010**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almira Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Cukalovic, gjyqtar
Gjylieta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Rexhep Rahimaj, me vendbanim në Kamenicë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi e konteston Vendimin e Gjykatës së Qarkut në Gjiilan, Ac. nr. 359/10, të 14 dhjetorit 2010, i cili i ishte dorëzuar më 6 janar 2011.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi pohon që vendimi i kontestuar i Gjykatës së Qarkut në Gjiilan shkel Ligjin Nr. 03/L-008 për procedurën përmbaremore, pasi e shtyu përmbaremin e vendimit *res judicata* të Gjykatës Komunale në Kamenicë, C. nr. 74/2007, të 28 shtatorit 2007.
4. Në këtë drejtim, parashtruesi pohon që i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), dhe me nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

5. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 22 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i 15 janarit 2009, (Nr. 03/L-121), (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe rregulli 56.1 i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë më 15 prill 2011.
7. Më 19 prill 2011, Kryetari, me Vendimin Nr. GJR. 51/11, e caktoi gjyqtarin Robert Carolan Gjyqtar raportues. Të njëjtën datë, Kryetari, me Vendimin Nr. KSH. 51/11, e caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Snezhana Botusharova (kryesuese), Enver Hasani dhe Gjyljeta Mushkolaj.
8. Më 2 qershor 2011, parashtruesi e dorëzoi Vendimin e Gjykatës Komunale në Kamenicë, C. nr. 74/2007, të 28 shtatorit 2007, siç u kërkua nga Gjykata. Parashtruesi gjithashtu e njoftoi Gjykatën se padia për pushimin e servitutit ende ishte pezull në të njëjtën gjykatë.
9. Më 8 korrik 2011, Gjykata Komunale në Kamenicë e njoftoi Gjykatën se procedura përmbaremore ishte shtyrë pasi të paditurit kishin parashtruar padi të re në Gjykatën Komunale në Kamenicë për pushimin e servitutit.
10. Më 11 prill 2011, Gjykata e Qarkut në Gjiilan e njoftoi Gjykatën se *“sipas informatave që i kemi marrë nga Gjykata Komunale në Kamenicë, Aktgjykimi i saj E. nr. 245/10 për lejimin e ekzekutimit sipas lëndës C. nr. 74/2007, është ende pezull, ngase lënda është në pritje për rivendosje nga ajo gjykatë”*.
11. Më 19. qershor 2012, Gjykata shqyrtoi dhe votoi lidhur me rastin.

Përmbledhje e fakteve

12. Në vitin 2007, parashtruesi ushtroi padi në Gjykatën Komunale në Kamenicë me të cilën pretendonte se fqinjët e kishin penguar atë në shfrytëzimin e servitutit të tij, pra për të hyrë dhe dalë nga prona e tij.

13. Më 28 shtator 2007, Gjykata Komunale në Kamenicë, me Vendimin C. nr. 74/2007, aprovoi padinë e parashtruesit dhe u urdhëroi fqinjëve t'i mundësonin parashtruesit hyrjen dhe daljen nga prona/shtëpia e tij. Gjykata Komunale vërtetoi se fqinjët "[...] kanë penguar [...]" parashtruesin e kërkesës "[...] në posedim-bashkëposedim të së drejtës së servitutit real, domethënë të shfrytëzojë rrugën në këmbë dhe me veturë, traktor apo makina tjera [...]", dmth fqinjët "[...] kanë kryer ndaj [...]" parashtruesit të kërkesës "[...] akt pengimi në posedim." Fqinjët ushtruan ankesë kundër këtij vendimi në Gjykatën e Qarkut në Gjiilan.
14. Më 17 dhjetor 2007, Gjykata e Qarkut në Gjiilan, me Vendimin AC. nr. 395/07, aprovoi ankesën e fqinjëve dhe ndryshoi vendimin e Gjykatës Komunale për shkak se kjo e fundit nuk i kishte vlerësuar në mënyrë adekuate situatën faktike dhe provat. Për këtë arsye, parashtruesi kërkoi nga prokurori publik të iniciojë kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme. Prokurori publik e paraqiti kërkesën më 28 shkurt 2008, duke theksuar që aktvendimi i Gjykatës së Qarkut "[...] përmbante shkelje esenciale të dispozitave të procedurës sepse paditësit [fqinjëve] me veprim të kundërligjshëm të gjykatës [Gjykatës Komunale], me mosdorëzim, nuk iu mundësua të deklarohet lidhur me provat [...]".
15. Më 10 qershorit 2009, Gjykata Supreme me Vendimin Mlc. nr. 11/2008 e ndryshoi Vendimin e Gjykatës së Qarkut në Gjiilan, Ac. nr. 395, të 17 dhjetorit 2007, dhe e vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Komunale në Kamenicë, C. nr. 74/2007, të 28 shtatorit 2007, me të cilin vërtetohet se fqinjët "[...] kanë penguar [...]" parashtruesin e kërkesës "[...] në posedim-bashkëposedim të së drejtës së servitutit real, domethënë të shfrytëzojë rrugën në këmbë dhe me veturë, traktor apo makina tjera [...]", dmth fqinjët "[...] kanë kryer ndaj [...]" parashtruesit të kërkesës "[...] akt pengimi në posedim." Gjykata Supreme vërtetoi se " Duke pasur parasysh se prova në të cilën mbështetet aktvendimi i kundërshtuar janë prova jorandësishme dhe fare nuk janë administruar nga gjykata e shkallës së parë ndërsa gjykata e shkallës së dytë aktvendimin e vet e mbështet në fotodokumentacion pa e hapur shqyrtimin pranë gjykatës së shkallës së dytë dhe e vlerësuar nga Gjykata Supreme e Kosovës si provë e cila nuk do të ndihmonte në ndryshimin e gjendjes faktike të vërtetuar me aktvendimin e gjykatës të shkallës së parë, Gjykata Supreme e pranoi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë si të bazuar dhe e ndryshojë aktvendimin e kundërshtuarë, ashtu që refuzoi ankesën e paraqitur kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe vërtetoi aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë me vlerësim se i njëjti nuk përmbanë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore."
16. Me vërtetimin e Gjykatës Supreme të vendimit të Gjykatës Komunale në Kamenicë, C. nr. 74/2007, të 28 shtatorit 2007, ky vendim bëhet i përmbarueshëm dhe *res judicata*.
17. Më 14 shtator 2010, Gjykata Komunale me vendimin E. nr. 245/10, miratoi kërkesën e parashtruesit për ekzekutim të vendimit të Gjykatës Komunale në Kamenicë, të 28 shtatorit 2007, C. nr. 74/2007, i cili ishte bërë *res judicata*, por fqinjët menjëherë e kundërshtuan ekzekutimin e këtij vendimi.
18. Më 7 tetor 2010, Gjykata Komunale me vendimin E. nr. 245/10 e hodhi poshtë si të pabazuar kundërshtimin e fqinjëve. Gjykata Komunale theksoi se "Në nenin 55 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (LPP), në mënyrë taksative janë numruar shkaqet për të cilat mund të ushtrohet prapësimi, por meqenëse në rastin konkret gjykata nuk ka gjetur asnjë nga shkaqet ligjore për të cilat mund të ushtrohet dhe aprovohet prapësimi, në kuptim të dispozitave nga neni 57 i LPP-së, i njëjti është dashur të refuzohet dhe vendoset si në dispozitiv të këtij aktvendimi". Fqinjët më pas paraqitën ankesë kundër këtij vendimi në Gjykatën e Qarkut në Gjiilan.

19. Më 14 dhjetor 2010, Gjykata e Qarkut në Gjilan me vendimin E.nr.145/10, e miratoi ankesën e fqinjëve dhe shtyu përbarimin e vendimit të dhe shtyu ekzekutimin e vendimit e 7 tetorit 2010, të Gjykatës Komunale, derisa ajo gjykatë të vendoste lidhur me kërkesat e fqinjëve të 25 gushtit dhe 17 shtatorit 2010 për **pushimin** e servitutit të parashtruesit. Gjykata e Qarkut arsyetoi që, pasi kërkesat e fqinjëve të 25 gushtit dhe 17 shtatorit 2010 për **pushimin** e servitutit të parashtruesit ishin vendosur në të njëjtën dosje, vendimi i Gjykatës Komunale për ta hedhur poshtë ankesën e fqinjëve kundër ekzekutimit të vendimit me të cilin konfirmohej servituti nuk ishte i drejtë dhe se parashtruesi dhe fqinjët duhej të pritnin përfundimin e procedurave lidhur me **pushimin** e servitutit. Gjykata e Qarkut iu referua nenit 68 të Ligjit për procedurën përbarimore, i cili parashihet që gjykata, me kërkesën e debitorit, mund ta shtyjë ekzekutimin në raste të tilla kur ekzistojnë shkaqet veçanërisht të arsyeshme që debitori, nëse ofron fakte të besueshme, do të pësonte dëme të mëdha për shkak të zbatimit të ekzekutimit.

Pretendimet e parashtruesit

20. Parashtruesi pohon që Vendimi i Gjykatës së Qarkut në Gjilan, Ac. nr. 359/10, i 14 dhjetorit 2010, ia privoi të drejtën e posedimit, e cila u njoh dhe vërtetua me vendimin gjyqësor të formës së prerë të Gjykatës Komunale në Kamenicë, C. nr. 74/2007, të 28 shtatorit 2007, i cili ishte bërë *res judicata*. Parashtruesi thekson se mohimi i një të drejte të tillë është shkelje thelbësore e të drejtës në pronë, të garantuar me nenin 46 [E Drejta në Pronë] të Kushtetutës dhe nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së, i cili përcakton që “Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë e tij”.
21. Përveç kësaj, parashtruesi pohon që dështimi për të vepruar në përputhje me një vendim gjyqësor të formës së prerë e bën të cenueshëm sundimin e ligjit në Kosovë dhe parimin e sigurisë juridike të qytetarëve. Kështu që, kjo është në kundërshtim me nenet 6 dhe 13 të KEDNJ-së.
22. Në lidhje me këtë, parashtruesi i referohet Aktgjykimit të Gjykatës në Rastin KI 08/09, të 17 dhjetorit 2010, ku Gjykata gjeti që “Sundimi i ligjit është një prej parimeve themelore të një shoqërie demokratike, presupozon respektimin e parimit të sigurisë juridike, sidomos në lidhje me vendimet gjyqësore që kanë marrë formën *res judicata*. Asnjë palë nuk ka të drejtë të kërkojë rishikimin e një aktgjykimi përfundimtar dhe të plotfuqishëm thjesht për qëllimin e fitimit të rishikimit dhe rishqyrtimit të freskët të rastit [...] Po të mos ishte kështu, kthimi prapa i vendimeve përfundimtare do të çonte në një klimë të përgjithshme të pasigurisë juridike, duke zvogëluar kështu besimin publik në sistemin gjyqësor.
23. Autoritetet kompetente, pra, kanë obligimin pozitiv që të organizojnë një sistem për zbatimin e vendimeve, i cili është efektiv edhe në kuptimin ligjor edhe në atë praktik, dhe i cili siguron zbatimin e tyre pa vonesa të panevojshme [...]” [...] Ekzekutimi i një aktgjykimi të marrë nga një gjykatë duhet shikuar si pjesë përbërëse e të drejtës për gjykim të drejtë, të garantuar me nenet e lartpërmendura [nenet 6 dhe 13 të KEDNJ-së]. [...] parashtruesit nuk do të duheshin privuar nga përfitimi i vendimit, i cili kishte marrë formë *res judicata*, në favorin e tyre”.
24. Së fundi, parashtruesi kërkon që Gjykata ta miratojë padinë e tij, duke e shpallur jokushtetues Vendimin e Gjykatës së Qarkut në Gjilan, AC. nr. 359, të 14 dhjetorit 2010, dhe duke urdhëruar ekzekutimin e Vendimit të Gjykatës Komunale, C. nr. 74/2007, të 28 shtatorit 2007.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

25. Për të qenë në gjendje të gjykojë për kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë, Ligj dhe Rregullore të punës.
26. Gjykata duhet të vlerësojë nëse parashtruesi është palë e autorizuar në kuptimin e nenit 113.7 Kushtetutës, i cili përcakton se: *“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”*. Në lidhje me këtë, kërkesa është parashtruar në Gjykatë nga individ. Prandaj, parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, me të drejtën t'i parashtrojë këtë rast Gjykatës sipas nenit 113.7 të Kushtetutës.
27. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës, në pajtim me nenin 49 të Ligjit, duhet të paraqesë kërkesën në afat prej 4 muajsh pas vendimit të fundit gjyqësor. Më 14 dhjetor 2010, Gjykata e Qarkut nxori Vendimin AC. nr. 359/10, përderisa parashtruesi e pranoi këtë Vendim më 6 janar 2011. Parashtruesi i paraqiti kërkesën Gjykatës më 15 prill 2011. Kështu që, parashtruesi i ka plotësuar kushtet e afateve për parashtrimin e kërkesës në Gjykatën Kushtetuese.
28. Përveç kësaj, në përputhshmëri me nenet 12 dhe 14 të LPP, Gjykata e Qarkut në Gjilan konsiderohet “instanca e fundit për të gjykuar përmbarimin e çështjes në fjalë”. Si rrjedhojë, parashtruesi i kërkesës i ka shterur të gjitha mjetet ligjore të parapara me ligjet e Kosovës. *Shih SHTOJCËN e këtij AKTGJYKIMI*
29. Përfundimisht, neni 48 i Ligjit përcakton: *“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”* Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës konteston Vendimin e Gjykatës së Qarkut AC. nr. 359/10, ku pretendohet se i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenet 31 [E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm] dhe 46 [Mbrotjtja e pronës] të Kushtetutës, si dhe neni 1 i Protokollit 1 të KEDNJ, pasi që me atë Vendimin përmbarimi i Vendimit *res judicata* C.nr. 74/2007 të Gjykatës Komonale në Kamenicë të 28 shtatorit 2007 ishte shtyrë. Prandaj, parashtruesi i kërkesës ka plotësuar edhe këtë kusht.
30. Pasi që parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i ka respektuar afatet për parashtrimin e kërkesës në Gjykatë, i ka shterur të gjitha mjetet juridike dhe i ka qartësuar saktësisht shkeljet e pretenduara të të drejtave dhe lirive, përfshirë vendimin të cilin e konteston, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë.

Vlerësimi kushtetues i kërkesës

31. Pasi që parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kushtet procedurale të pranueshmërisë, Gjykata duhet të shqyrtojë themelësinë e ankesës së parashtruesit.
32. Lidhur me parashtruesin e parashtruesit, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës konteston Vendimin e Gjykatës së Qarkut në Gjilan, AC. nr. 359/10, të 14 dhjetorit 2010, me të cilin, me të cilin, në përputhshmëri me nenin 68 të LPP, shtyhet përmbarimi i vendimit të Gjykatës Komonale të 7 tetorit 2010.
33. Sa i përket ankesës së parashtruesit, Gjykata vëren që, më 14 shtator 2010, Gjykata Komonale lejoi ekzekutimin e vendimit të vet *res judicata*, të 28 shtatorit 2007, siç u

- kërkua nga parashtruesi, por që, siç u cek më sipër, Gjykata e Qarkut në Gjilan e pezulloi ekzekutimin për shkak se më 25 gusht dhe 17 shtator 2010, fqinjët e parashtruesit/të paditurit kishin iniciuar procedurë të re në Gjykatën Komunale në Kamenicë, duke kërkuar kësaj radhe pushimin e servitutit të parashtruesit.
34. Kjo u vërtetua nga Kryetari i Gjykatës Komunale në Kamenicë në shkresën e tij, të 8 korrikut 2011, drejtuar kësaj Gjykate, në të cilën thuhej që procedura përmbarimore lidhur me vendimin *res judicata* ishte shtyrë pasi të paditurit [fqinjët e parashtruesit] kishin parashtruar padi të re për pushimin e servitutit të parashtruesit.
 35. Lidhur me këtë,, parashtruesi pretendon se janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet 31 [E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm] dhe 46 [Mbrojtja e pronës] e Kushtetutës dhe nenit 1 të Protokollit 1 të KEDNJ sepse vendimi *res judicata* i Gjykatës Komunale në Kamenicë, Vendimi C. nr. 74/2007 i datës 28 shtator 2007, nuk ishte ekzekutuar.
 36. Prandaj, Gjykata gjithashtu duhet të gjykojë nëse Gjykata e Qarkut, me rastin e pezullimit të ekzekutimit të vendimit *res judicata* të Gjykatës Komunale ka mundur ta bëjë atë pasi fqinjët/kundërshtarët e parashtruesit kishin parashtruar padi të re për pushimin e servitutit të parashtruesit.
 37. Në këtë drejtim, Gjykata dëshiron të ritheksojë se gjetjet e saj në Rastin KI 08/09, të 17 shtatorit 2010, në të cilin përcaktoi që “Sundimi i ligjit është një prej parimeve themelore të një shoqërie demokratike, presupozon respektimin e parimit të sigurisë juridike, sidomos në lidhje me vendimet gjyqësore që kanë marrë formën *res judicata*. Asnjë palë nuk ka të drejtë të kërkojë rishikimin e një aktgjykimi përfundimtar dhe të plotfuqishëm thjesht për qëllimin e fitimit të rishikimit dhe rishqyrtimit të freskët të rastit (shih, *mutatis mutandis*, GJEDNJ 2002-VII) [...]. Po të mos ishte kështu, kthimi prapa i vendimeve përfundimtare do të çonte në një klimë të përgjithshme të pasigurisë juridike, duke zvogëluar kështu besimin publik në sistemin gjyqësor”.
 38. Gjykata më tej konstatoi që: “Prandaj, autoritetet kompetente kanë obligimin pozitiv që të themelojnë një sistem për zbatimin e vendimeve, i cili është efektiv edhe në kuptimin ligjor edhe në atë praktik, dhe i cili siguron zbatimin e tyre pa vonesa të panevojshme [...]” [...]. Ekzekutimi i një aktgjykimi të marrë nga një gjykatë duhet shikuar si pjesë përbërëse e të drejtës për gjykim të drejtë, të garantuar me nenet e lartpërmendura [nenet 6 dhe 13 të KEDNJ-së]. [...] parashtruesit nuk do të duheshin privuar nga përfitimi i vendimit, i cili kishte marrë formë *res judicata*,
 39. Gjykata më tej vëren se në përputhshmëri me nenin 68 të LPP, shtyrja e përmbarimit mund të bëhet vetëm me kërkesën e kreditorit dhe jo me kërkesën e debitorit siç ka theksuar Gjykata e Qarkut në Gjilan, në vendimin e vet Ac. nr. 359/10 të 14 dhjetorit 2010. *Shih SHTOJCËN e këtij AKTGJYKIMI*
 40. Sa i përket kërkesës në fjalë, Gjykata konsideron që Gjykata e Qarkut në Gjilan ka vepruar në kundërshtim me nenin 31 të Kushtetutës duke shtyrë vendimin për ekzekutimin e vendimit *res judicata* të Gjykatës Komunale.
 41. Në këto rrethana, Gjykata konstaton që janë shkelur të drejtat e parashtruesit për gjykim të drejtë dhe efektiv, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe se vendimi *res judicata* i Gjykatës Komunale në Kamenicë, Vendimi C.nr.74/2007, i datës 28. Shtator 2007, duhet përmbaruar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 56 (1) të Rregullores së Punës, në seancën e mbajtur më 19 qershor 2012,


VENDOSI

- I. Njëzëri, TA SHPALLË kërkesën të pranueshme;
- II. Me shumicë votash, TA SHPALLË të pavlefshëm Vendimin Ac. nr. 359/10, të Gjykatës së Qarkut në Gjilan, të 14 dhjetorit 2010, i cili shkel nenin 31 të Kushtetutës;
- III. TA KTHEJË Vendimin Ac. nr. 359/10, të Gjykatës së Qarkut në Gjilan, të 14 dhjetorit 2010, për rishqyrtim në pajtueshmëri me aktgjykimin e kësaj Gjykate në bazë të rregullit 74 (1) të Rregullores së Punës;
- IV. Në bazë të rregullit 63 (5) të Rregullores së Punës, Gjykata e Qarkut në Gjilan duhet t'i dorëzojë informacione Gjykatës Kushtetuese për masat e ndërmarra në zbatimin e këtij aktgjykimi të Gjykatës Kushtetuese;
- V. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- VI. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese


Robert Carolan




Prof. dr. Enver Hasani

SHTOJCË

Dispozita të rëndësishme ligjore lidhur me vendimet gjyqësore:

Ligji 2008/03-L008 për Procedurën përmbartimore

Në Republikën e Kosovës, rregullat, procedurat e përmbartimit dhe sigurimi i vendimeve ligjore janë të rregulluara me Ligjin për Procedurën Përmbartimore (Ligji Nr. 2008/03-L008).

Neni 12 [Mjetet e goditjes së vendimeve]

“...

12.1 Në procedurën përmbartimore janë mjete të zakonshme goditjeje prapësimi dhe ankesa, poqëse nuk janë përjashtuar me këtë ligj.

12.2 Kundër aktvendimit të shkallës së parë mundë të paraqitet prapësimi, kurse ankesa vetëm në rastet e parapara me këtë ligj.

12.3 Prapësimi i paraqitet gjykatës që e ka dhënë aktvendimin brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të aktvendimit, po qe se me këtë ligj nuk është paraparë ndryshe. Për prapësimin e paraqitur vendosë gjykata që e ka dhënë aktvendimin.

12.4 Kundër aktvendimit të dhënë lidhur me prapësimin mund të paraqitet ankesa brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të aktvendimit.

12.5 Për ankesën e paraqitur është kompetente të vendos gjykata e shkallës së dytë.

12.6 Prapësimi dhe ankesa nuk e ndalin procedurën përmbartimore, por përmbushja e kërkesës së propozuesit të përmbartimit shtyhet deri sa mos të vendosë gjykata e shkallës së parë për prapësimin e paraqitur. Përjashtimisht kur me titullin ekzekutiv është caktuar detyrimi i ushqimit ligjor, apo kur përmbartimi kryhet duke u kaluar të hollat nga llogaria e transaksionit të personit juridik në llogarinë e llojit të njëjtë të propozuesit të përmbartimit, por edhe në rastet tjera të parapara me këtë ligj, mund të realizohet kredia edhe para se të vendoset për prapësimin e debitorit.

12.7 Kundër konkluzionit si lloj i vendimit në parim nuk lejohet mjete i goditje.

...”

Neni 13 [Forma e prerë dhe përmbartueshmëria]

“...

13.1 Aktvendimi kundër të cilit nuk është paraqitur brenda afatit ligjor prapësimi, bëhet i formës së prerë dhe i përmbartueshëm.

13.2 Aktvendimi kundër të cilit është refuzuar prapësimi bëhet i përmbartueshëm, e po qe se kundër tij nuk është e lejueshme ankesa, ai bëhet edhe i formës së prerë.

13.3 Aktvendimi me të cilin është refuzuar prapësimi bëhet i formës së prerë po qe se kundër tij nuk paraqitet ankesa brenda afatit ligjor, ose në qoftë se ankesa e paraqitur refuzohet si e pathemeltë.

*13.4 Po qe se me këtë ligj është paraparë se kundër aktvendimit të shkallës së parë mund të paraqitet ankesa në vend të prapësimit, atëherë aktvendimi i tillë bëhet përmbartimore, kurse i formës së prerë po qe se nuk paraqitet ankesa brenda afatit ligjor, ose kur ankesa e paraqitur refuzohet si e pabazë.
...*

Neni 14 [Mjetet e goditjes së jashtëzakonshme]

“... ”

14.1 Kundër aktvendimit të nxjerrë në formë të prerë në procedurën përmbartimore dhe të sigurimit nuk lejohet revizioni as përsëritja e procedurës.

14.2 Kthimi në gjendjen e mëparshme lejohet vetëm në rast të mosruajtjes së afatit për paraqitjen e prapësimit dhe të ankesës kundër aktvendimit të përmbartueshëm për përmbartimin e detyrueshëm.

“... ”

KREU VII Shtyrja, Pezullimi dhe Përfundimi i Përmbartimit

Neni 68 [Shtyrja e përmbartimit sipas kërkesës së kreditorit]

“... ”

68.1 Po qe se me ligj nuk është paraparë ndryshe, përmbartimi mund të shtyhet pjesërisht apo tërësisht vetëm sipas kërkesës së propozuesit të përmbartimit, por vetëm në qoftë se ende nuk ka filluar të zbatohet aktvendimi për përmbartimin. Po qe se në procedurën e përmbartimit marrin pjesë më tepër propozues të përmbartimit e vetëm ndonjëri nga ta e kërkon shtyrjen, atëherë gjykata e shtyn përmbartimin vetëm për aq sa i përket propozuesit të tillë të përmbartimit.

68.2 Po qe se zbatimi i përmbartimit ka filluar, kurse debitori brenda afatit të caktuar nga gjykata është deklaruar kundër shtyrjes, atëherë gjykata do të vendosë për arsyeshmërinë e kërkesës për shtyrje.

68.3 Në qoftë se me ligj është paraparë se përmbartimi mund të propozohet vetëm brenda afatit të caktuar, atëherë propozuesi i përmbartimit mund të paraqesë kërkesën për shtyrje të përmbartimit vetëm brenda afatit të tillë.

“... ”

Neni 69 [Koha për të cilën shtyhet përmbartimi]

“... ”

69.1 Gjukata e shtyn përmbartimin për kohën që e ka caktuar propozuesi i ekzekutimit, apo për kohën të cilën e quan të arsyeshme duke i marrë parasysht rrethanat e rastit konkret.

69.2 Në qoftë se me ligj është paraparë afati brenda të cilit mund të propozohet ekzekutimi, atëherë shtyrja e tij nuk mund të bëhet tej afatit të tillë.

...”

Neni 70 [Vazhdimi i procedurës së shtyrë]

“...

Përmbartimi i shtyre vazhdohet sipas kërkesës së propozuesit të përmbartimit edhe para se të skadojë koha për të cilën është shtyer. Po qe se propozuesi i përmbartimit nuk e kërkon vazhdimin e procedurës as pas 15 ditësh, nga dita e skadimit të afatit për të cilin është shtyre përmbartimi, atëherë gjykata do ta përfundojë procedurën e ekzekutimit të shtyre me aktvendim me të cilin supozohet se është tërheq propozimi për përmbartim.

...”